



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Tiranë, më 17. 09. 2020

NJOFTIM PËR BOTIM NË REVISTËN PEDAGOGJIKE

Të nderuar bashkëpunëtorë dhe të interesuar për të botuar në Revistën Pedagogjike,

Ju njoftojmë se janë hapur aplikimet për të dërguar artikuj për numrin e ri të Revistës Pedagogjike, 2020. Kjo revistë është botim i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me ISSN 0304-3509.

Fokusi i revistës në këtë numër është **“Kurrikula, zhvillimi profesional i mësuesve dhe i drejtuesve, sigurimi i cilësisë dhe vlerësimi i performancës së arsimit parauniversitar, në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID - 19”**. Përmes këtij fokusi synojmë të mundësojmë ndarjen e ideve, parashtrimin e analizave, përvojave dhe kërkimeve.

Artikujt mund të sjellin analiza, parashtrime, reflektime, kërkime dhe opinionca mbi tematikat e mëposhtme:

I. Fusha “Kurrikula dhe zhvillimi i profesional i mësuesve dhe i drejtuesve në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID- 19” - Analiza, përvoja, modele, sfida

- Kurrikula, planifikimi i mësimdhënies dhe të nxënësve, si dhe metodologjia për realizimin dhe zbatimin e kurrikulës.
- Vlerësimi i nxënësve.
- Edukimi në fëmijërinë e hershme.
- Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie.
- Fuqizimi i kapaciteteve të mësuesve, drejtuesve, mësuesve ndihmës, psikologëve shkollorë, rrjeteve profesionale.
- Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës në kushtet e pandemisë COVID- 19.

II. Fusha “Sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID -19” – Analiza, përvoja, modele, sfida

- Vlerësimi jashtëm i shkollës në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID -19:
 - a) për menaxhimin e kurrikulës, stafit dhe burimeve;
 - b) për kurrikulën e zbatuar në mjedisin e shkollës.
- Garantimi i zbatimit të masave për sigurinë e nxënësve në mjediset e shkollës, gjatë pandemisë COVID-19.
- Vlerësimi i brendshëm i shkollës në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID -19.

III. Fusha “Vlerësimi i performancës së arsimit parauniversitar në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19” - Analiza, përvoja, modele, sfida

- Funksionimi i institucioneve arsimore parauniversitare në kushtet e pandemisë COVID-19.
- Efikasiteti i masave të marra nga institucionet arsimore në kushtet e pandemisë COVID-19.
- Përshtatja e kuadrit rregullator për/me funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar në kushtet e pandemisë COVID -19 (vendime, urdhra, udhëzime, rregullore etj.).
- Përvojat ndërkombëtare të menaxhimit të sistemit arsimor në kushtet e pandemisë COVID -19.

**PROCESI I PËRZGJEDHJES DHE I PRANIMIT PËR BOTIM NË REVISTËN
PEDAGOGJIKE**

Faza e parë– Dorëzimi i abstraktit

Në fazën e parë të aplikimit, të interesuarit për botim dorëzojnë një abstrakt të çështjeve kryesore që artikulli merr përsipër të trajtojë. Çdo autor ka të drejtë të sjellë vetëm një artikull për botim.

Formati i abstraktit

Titulli i artikullit:

Emri dhe mbiemri i autorit/autorëve:

Titulli/Grada (nëse ka):

Institucioni ku punon:

Abstrakti i artikullit *ku përshkruhet fokusi i tij me jo më shumë se 200-250 fjalë.*

Fjalë kyç: 5 – 10 fjalë

Afati përfundimtar për fazën e parë të aplikimit është 15 tetor 2020.

Faza e dytë – Miratimi i abstrakteve dhe përgatitja e artikujve

Në fazën e dytë, pas shqyrtimit të abstrakteve nga bordi editorial i revistës, ju do të njoftoheni përmes email-it për pranimin e abstraktit dhe vazhdimin më tej të përgatitjes së artikullit, si dhe dorëzimin në afatin e përcaktuar.

Formati i artikullit të plotë

Titulli i artikullit:

Emri dhe mbiemri i autorit/autorëve:

Abstrakt:

Fjalët kyç:

Hyrje:

Shtjellimi i çështjeve kryesore të artikullit:

Rezultate mbi çështjet kryesore:

Konkluzione/diskutime:

Rekomandime:

Bibliografia:

Kritere për përgatitjen e artikujve të Revistës Pedagogjike

- Numri i faqeve të artikullit duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 12 faqe.
- Formatu është A4, shkrim 12, Times New Roman, me një hapësirë single midis rreshtave.
- Artikulli duhet të jetë i shoqëruar me një abstrakt 200-250 fjalë.
- Referencat përgjatë artikullit duhet të vendosen me numra dhe në fund të faqes të vendoset referenca e plotë me shkrim 10, Times New Roman.

- Në fund të artikullit duhet të vendoset bibliografia që përfshin autorin, titullin e botimit, shtëpinë botuese, vendin, vitin e botimit, numrin e faqeve.

Abstraktet dhe artikujt do të dorëzohen brenda datës 30 nëntor 2020, në formë elektronike në adresën: sekretaria@scap.edu.al